Kronikë

Kurbin/ Makinës së 34-vjeçarit i vendoset tritol, por nuk shpërthen! Identifikohet autori

Makinës së një 34-vjeçari në Kurbin i është vendosur tritol paraditen e sotme, 11 prill. Mësohet se mjeti ka qenë i parkuar pranë një lokali në afërsi të fshatit Malbardhë në Kurbin.

Redaksia
11 Prill, 11:58 | **Përditesimi: 11 Prill, 14:47**

Share

KURBIN- Makinës së një 34-vjeçari në Kurbin i është vendosur tritol paraditen e sotme, 11 prill. Mësohet se mjeti ka qenë i parkuar pranë një lokali në afërsi të fshatit Malbardhë në Kurbin.

Fatmirësisht lënda plasëse nuk ka shpërthyer, ndërsa pronari i automjetit F. L., 34 vjeç, ka njoftuar menjëherë Policinë e Kurbinit. Ekspertët xhenierë kanë bërë të mundur çaktivizimin e lëndës plasëse.

Ndërkohë, policia ka identifikuar autorin që vendosi lëndën plasëse dhe është shpallur në kërkim. Sipas policisë, autori rezulton të jetë i afërm i 34-vjeçarit dhe ia ka vendosur lëndën plasëse për ta kanosur.

[Sh.com]

LEXO EDHE:
Kthyen stanin në 'shtëpi bari', Report Tv siguron videon e arrestimit të Armando Ndrecës, vëllait të deputetit të PS! U prangos pranë një servisi në Lezhë

"Si rezultat i veprimeve të shpejta dhe profesionale hetimore u bë i mundur identifikimi dhe shpallja në kërkim e autorit të dyshuar të këtij rasti, shtetasit A. L. (i afërm i shtetasit F. L.). Nga këto veprime dyshohet se ky shtetas e ka vënë lëndën plasëse, për të kanosur shtetasin F. L., për shkak të konflikteve të mëparshme me të", njofton policia.

Ndërkohë, ka nisur hetimi në gjendje të lirë për shtetasin Z. L., pasi dyshohet si bashkëpunëtor në këtë rast.

Sl.E./Shqiptarja.com

TAG: tritol Lezhe

Komento

© Ndalohet rreptësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

SH.COM

Sondazhi i ditës:
Kuvendi nuk dërgon në Kushtetuese mandatin e Xhaçkës, si e vlerësoni?

Të drejtë | Të gabuar | Nuk e di

HOROSKOPI

RAPORTO! Chat live me Shqiptarja.com
GetButton

Lajme të tjera

Nga Skënderbeu tek Fishta, Bledar Çakalli vizaton muralen nacionaliste në Rrugën e Kombit

Elvis Hila

11 Prill, 15:54

U përgjua telefonata me kunatin që mbillte kanabis, si ra në 'grackën' e policisë Armando Ndreca, vëllai i deputetit socialist të Lezhës, Eduard Ndreca

11 Prill, 12:39

Kthyen stanin në 'shtëpi bari' në Lezhë, 2 në pranga! Ndalohet vëllai i deputetit të PS, Eduard Ndreca! Sekuestrohen 3 mijë bimë kanabisi (VIDEO)

11 Prill, 10:25

SHËRBIMI I EMERGJENCËS SHËNDETËSORE
SHËRBIMI I EMERGJENCËS SHËNDETËSORE
SHËRBIMI I EMERGJENCËS SHËNDETËSORE